

Zhvillohet në KLSH vizita studimore e drejtuesve të Departamentit për Çështjet Juridike kundër Mashtrimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

Në kuadër të thellimit të bashkëpunimit të ndërsjellë, u zhvillua në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit në datat 4-5 nëntor 2024, një vizitë studimore e drejtuesve të Departamentit për Çështjet Juridike kundër Mashtrimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (ZKA).

Përfaqësuesit e ZKA-së u pritën gjatë ditës së parë të vizitës nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit z. Arben Shehu, Drejtori i Përgjithshëm, znj. Marjola Llanaj dhe drejtuesit e Drejtorisë Juridike në Kontrollin e Lartë të Shtetit.



Qëllimi i kësaj vizite dyditore ishte shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira lidhur me procesin e përcjelljes së rasteve në Prokurori të procedimeve penale. Gjatë diskutimeve u trajtua roli i Kontrollit të Lartë të Shtetit në parandalimin dhe identifikimin e rasteve abuzive dhe veprave penale, si dhe detyrat e Kontrollit të Lartë të Shtetit lidhur me materialet që dërgohen në Prokurori.

Vëmëndje e veçantë iu kushtua rolit të grupit të auditimit në identifikimin e rasteve që mund të dërgohen në Prokurori, rekomandimi për kallëzim penal ose sugjerimi për trajtim të detajuar tekniko-juridik të materialeve sipas parashikimeve të Kodit Penal.

Më pas diskutimi vijoi me rolin që ka Drejtoria Juridike në përgatitjen e materialeve që dërgohen në Prokurori dhe marrjen e veprimeve konkrete në lidhje me to.

Gjithashtu, një çështje që u paraqit me rëndësi gjatë këtyre diskutimeve ishte thirrja e audituesve në organet e ndjekjes penale, si dhe në gjykatë, në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e çështjes.

Në përmbyllje të këtij takimi, u diskutuan të drejtat procedurale të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në rastet kur merr cilësinë e kallëzuesit, si dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera dhe me prokurorinë në luftën kundër kriminalitetit.